

Plani i kursit të arsimit komunal për të rritur, të suedishtes për imigrantë

Qëllimi i arsimit

Arsimi komunal për të rritur për imigrantë, është një arsim i kualifikuar gjuhësor, që ka për qëllim, që imigrantëve të rritur t'u jap dituri themelore në gjuhën suedishte. Një nxënës me një gjuhë tjetër amtare se sa suedishtja, përmes këtij arsimit duhet të mësoj dhe të zhvilloj një gjuhë të dytë funksionale. Ky arsim, do t'u jap vegla gjuhësore për komunikim dhe pjesëmarrje aktive në jetën e përditshme, atë profesionale dhe shoqërore si dhe për vazhdim të studimeve. Ky arsim, po ashtu ka për qëllim që t'u jap të rriturve të imigruar aftësi themelore shkrimi dhe leximi, nëse ata nuk i zotërojnë këto aftësi. Nëse një nxënës nuk ka aftësi funksionale leximi ose ka ndonjë sistem tjetër të shkruarit, përveç alfabetit latin, atij nxënësi do t'i jepet mësim në të shkruar dhe lexuar, në kuadër të kornizës së këtij arsimit.

Mësimi duhet t'u dedikohet njerëzve me përvoja të ndryshme, situata të ndryshme jetësore, dituri dhe objektiva të ndryshme të arsimit. Mësimi duhet të planifikohet dhe të organizohet bashkë me nxënësin dhe t'i përshtatet interesave, përvojave, diturive të përgjithshme dhe objektivave afatgjate të nxënësit.

Mësimi, duke u nisur nga nevojat e individit, duhet mundësuar që të kombinohet me punë apo aktivitete të tjera si për shembull, orientim në jetën profesionale dhe orientim shoqëror, vlefshmërinë, praktikë apo ndonjë arsim tjetër. Pra, mësimi duhet të formësohet në mënyrë sa më të ndryshueshme që është e mundur, kur është në pyetje koha, vendi, përmbajtja dhe format e punës.

Objektivi dhe karakteri i arsimit

Përmes arsimit, në kuadër të arsimit komunal për të rritur, të suedishtes për imigrantë, nxënësit i duhet dhënë mundësi për të zhvilluar

- aftësinë e vet për të shkruar dhe lexuar suedisht,
- aftësinë e vet për të folur, biseduar, lexuar, dëgjuar dhe të kuptuarit e suedishtes në kontekste të ndryshme,
- aftësinë e vet të përshtat gjuhën sipas bashkëbiseduesit dhe situatave,
- shqiptim të mirë,
- të kuptuarit se si mësohet një gjuhë,
- strategjitë e të mësuarit dhe të komunikuarit, për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës,
- aftësinë e vet për të përdorur teknikën digjitale dhe veglat përkatëse, për të mësuar dhe komunikuar, si dhe
- aftësinë e vet për të marrë qëndrim, ndaj informacionit nga burimet e ndryshme.

Arsimi komunal për të rritur i suedishtes për imigrantë, karakterizohet nga ajo që nxënësi të zhvilloj një aftësi komunikimi gjuhësor. Kjo do të thotë, të di të komunikoj si me gojë ashtu edhe me shkrim, varësisht nga nevojat e tij. Nxënësi duhet të marrë dituri dhe aftësi të llojeve të ndryshme, për të mundur të bëjë zgjedhjen përkatëse gjuhësore, në raport me situatën aktuale të komunikimit. Aftësia e komunikimit gjuhësor përfshinë aftësi të ndryshme, të cilat bashkëveprojnë dhe kompletojnë njëra tjetrën. Një aftësi e komunikimit gjuhësor nënkupton

si mundësi shfrytëzimi të një sistemi gjuhësor dhe diturive, se si të përdoret ky sistem.

Mësimi duhet t'ijep mundësi nxënësit të zhvillojë dituritë dhe aftësitë e ndryshme, për të mund të bëjë zgjedhjen përkatëse gjuhësore, në raport me situatën aktuale të komunikimit. Dituria për sistemin gjuhësor përfshinë fjalë, fraza, shqiptimin dhe strukturat gramatikore, ndërsa dituria e përdorimit të gjuhës bënë fjalë, se si mund të ndërtohet një tekst dhe si bëhet zgjedhja gjuhësore funksionale dhe si bëhet përshtatja e gjuhës, në raport me bashkëbiseduesin dhe qëllimit të bisedës. Një aftësi e rëndësishme është edhe të jesh në gjendje të përdoren strategji dhe media të ndryshme, që në mënyrën më efikase, ta bëjë të qartë mesazhin e vet.

Në mësim, nxënësi duhet të haset në tekste të llojeve të ndryshme, ku fjalë, fotografi dhe zë, bashkëveprojnë, me ose pa vegla digjitale. Mësimi duhet të kontribuoj që nxënësi të zhvilloj vetëdijen e tij se si bëhet mësimi i një gjuhe dhe të kuptuarit se si ai/ajo mund të mësoj. Nxënësit duhet, po ashtu, t'ijepet mundësi të zhvillojë aftësinë e vet ndërkulturore, duke reflektuar mbi përvojat e veta kulturore dhe duke i krahasuar ato me dukuritë në jetën e përditshme, shoqërore, studimore dhe profesionale në Suedi.

Mësimi mundet, edhe të kontribuoj që nxënësi të zhvillojë aftësinë e vet, për të përdorur teknikën digjitale, vegla përkatëse dhe medime të informimit, komunikimit dhe mësimi.

Përmes mësimi të njohurive bazë të shkrimit dhe leximit, nxënësit i duhet dhënë mundësia që

- të zhvillojë të kuptuarit, se si shkrimi përcjell mesazhin dhe si është e ndërtuar gjuha,
- të zhvillojë aftësinë e vet të përdorë gjuhën në rrethana të ndryshme,
- të zbatojë rregullat e zakonshme të gjuhës së shkruar,
- të përdor leximin dhe shkrimin për të mësuar, kuptuar dhe për t'u shprehur,
- të vetëdijesohet se si mësohet gjuha,
- të zhvillojë disa strategji të thjeshta për leximin dhe shkrimin me synime të ndryshme, si dhe
- të përdorë teknikën digjitale dhe mjetet ndihmëse, për të mësuar shkrim dhe lexim.

Strukturimi i arsimit

Arsimi komunal për të rritur i suedishtes për imigrantë, përbëhet nga tri rrugë të ndryshme studimi, 1, 2 dhe 3, si dhe katër kurseve të ndryshme, A, B, C dhe D. Rruga 1 e studimit përbëhet nga kurset A, B, C dhe D, rruga 2 e studimit, nga kurset B C dhe D si dhe rruga 3 e studimit, nga kurset C dhe D. Rrugët e ndryshme të studimit ju dedikohen personave me prejardhje, parakushte dhe synime të ndryshme. Rrugët e studimit tregojnë në cilin kurs hyrës ose me çfarë takti përparimi është i përshtatshëm. Një nxënës fillon shkollimin e vet, në atë rrugë studimi dhe në atë kurs në kuadër të rrugës së studimit, që i përshtatet më së miri parakushteve të tija/saja individuale. Kërkesat për diturinë për një kurs, janë njësoj, pavarësisht rrugës së studimit.

Rruga 1 e studimit, në rend të parë ju dedikohet personave që kanë shumë pak shkollim nga e kaluara, ndërsa rruga 3 e studimit personave që janë mësuar të studiojnë.

Vlerësimi, se cila rrugë studimi është e përshtatshme për një nxënës dhe në cilin kurs në kuadër të rrugës së studimit është mirë t'ia filloj nxënësi, duhet të nisët nga një përshkrim sistematik i diturive të tij ose të saj, parakushtet dhe çfarë mund të ketë rëndësi për mundësitë t'ijplotësojë kërkesat.

Kurset e tre rrugëve të studimit, marrin formësim të ndryshme, varësisht nga përvoja e nxënësit për të studiuar, arsimimit të mëhershëm dhe njohurive të suedishtes në fillim të kursit.

Një nxënës mund ta përfundojë arsimin komunal për të rritur të suedishtes për imigrantë ose kursin përkatës. Ndërkaq, të gjithë nxënësve u duhet dhënë mundësia të studiojnë, deri në kursin D, në kuadër të rrugës së vet të studimit, me atë përshtatje të kërkuar, që nxënësit t'i arrijnë nivelet e kërkuara të diturisë.

Të mësuarit bazë e shkrim-leximit

Arsimi sa i përket mësimin të shkrim-leximit, ju dedikohet personave pa shkollim të mëhershëm dhe personave që kanë shkollim të pakët dhe nuk dinë lexim funksional. Përmes mësimin në kuadër të arsimit komunal për të rritur të suedishtes për imigrantë dhe kryesisht në rrugën 1 të studimit, kanë mundësi të marrin aftësitë bazë të shkrim-leximit, çka përshinë thellimin dhe automatizimin e diturive të veta. Të bëhet me aftësi funksionale leximi, në kuptimin e vërtetë bazë dhe kjo mund të marrë kohë të gjatë.

Mësimi në aftësimin bazë të shkrim-leximit, mund të ketë nevojë edhe në rrugën e studimit 2 dhe 3, për nxënësit që dinë lexim, nëse nxënësit zotërojnë alfabetin latin. Në këtë rast procesi i mësimin duket më ndryshe.

Arsimi në lidhje me mësimin bazë të shkrim-leximit, lidhet me ndonjërin nga kurset A-D, por përbëjnë një pjesë personale që kombinohet me këto kurse. Pra, është një proces i cili mund të vazhdojë gjatë gjithë asaj kohe që nxënësi merr pjesë në arsimin komunal për të rritur të suedishtes për imigrantë, ashtu që aftësitë të arrijnë të automatizohen.

Mësimi në aftësimin bazë të shkrim-leximit, mund të bëhet në gjuhën amtare të nxënësit ose në një gjuhë tjetër që e zotëron nxënësi.

Vlerësimi

Pikënisja e vlerësimin duhet të jetë aftësia e nxënësit për të përdorur gjuhën suedishte në mënyrë të kuptueshme, për qëllime të ndryshme, në jetën e përditshme, në shoqëri, punë si dhe vazhdimin e studimeve.

Vlerësimi duhet të përfshijë dituritë e nxënësit, në përputhshmëri me kërkesat për dituri, për notat A, B, C, D dhe E. Kërkesat për diturinë janë të formuluar duke u bazuar në pesë fusha diturie: kuptimi përmes dëgjimit, kuptimi përmes leximit, ndikimit reciprok, prodhimit gojor dhe aftësisë së shkrimit. Fushat e diturisë, nuk duhen vlerësuar veçmas nga njëra tjetra, por mësuesi duhet të bëjë një vlerësim të tërësisë së aftësisë gjuhësore të nxënësit, duke u bazuar se sa nxënësi faktikisht ia del, nga aspekti gjuhësor.

Korrektesia gjuhësore duhet të lidhet me aspektin kompleks të përmbajtjes dhe të gjuhës.

Sipas kapitullit 20, 35 § të ligjit mbi shkollën (2010:800), duhet venë nota për çdo kurs të përfunduar. Në atë pjesë të arsimit që vlen për mësimin bazë të shkrim-leximit, nuk vihet notë.

Njohuria e kërkuar

Të kuptuarit përmes dëgjimit

Kursi A

Nxënësi me ndihmë kupton qartë, të folurit e thjeshtë në situata konkrete të përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi kupton fjalë të zakonshme dhe fraza të thjeshta të ngjarjeve të shkurta, të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë, që është në interes të nxënësit.</p> <p>Nxënësi tregon se kupton udhëzime të thjeshta gojore duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota D do të thotë, se njohuritë e kërkuara për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi kupton fraza dhe fjali të thjeshta të ngjarjeve të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë që është në interes të nxënësit.</p> <p>Nxënësi tregon se kupton udhëzime të thjeshta gojore, duke vepruar në mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota B do të thotë, se njohuritë e kërkuara për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi kupton fjali dhe fraza të një konteksti të ngjarjeve të ripërsëritura në përditshmëri dhe kupton informacion të përshtatur dhe të qartë që është në interes të nxënësit.</p> <p>Nxënësi shpreh se kupton udhëzime të thjeshta gojore duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p>

Kursi B

Nxënësi mund të kuptojë qartë, të folurit e thjeshtë në situata të zakonshme në jetën e përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi tregon se kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura rreth temave të mirënjohura duke e bërë një përmbledhje të thjeshtë të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi shpreh, se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme, duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesave të njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura, rreth temave të njohura, duke e bërë një përmbledhje të thjeshtë të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe të qarta dhe udhëzime në jetën e përditshme, duke vepruar në mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesave të njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon se i kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, biseda, informacione dhe lajme të përshtatura, rreth temave të mirënjohura, duke bërë një përmbledhje të thjeshtë të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme dhe të tregojë ndonjë nuancë të vetme.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe gojore të shkurta dhe udhëzime në jetën e përditshme, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>

Kursi C

Nxënësi mund të kuptojë qartë, të folurit e thjesht në situata të përditshme të rëndomta shoqërore, studimore dhe të punës, në jetën e përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi tregon, se kupton ngjarjet e ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacione dhe lajme të shkurta, rreth temave të njohura, duke e bërë një përmbledhje të thjesht të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe të thjeshta dhe të qarta gojore si dhe udhëzime duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon, se kupton ngjarjet e shkurta të ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacion dhe lajme të shkurta rreth temave të njohura, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe gojore të thjeshta dhe të qarta dhe udhëzime duke vepruar në një mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon, se kupton ngjarjet e ripërsëritura, përshkrime, biseda, informacion dhe lajme të shkurta, rreth temave të njohura, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme dhe disa nuanca.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe gojore të thjeshta dhe të qarta dhe udhëzime, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>

Kursi D

Nxënësi mund të kuptojë qartë të folurit në situata formale dhe joformale të jetës së përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi tregon, se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacion dhe lajme rreth temave të njohura, duke e bërë një përmbledhje të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësi, duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacion dhe lajme rreth temave të njohura, duke e bërë një përmbledhje të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi tregon se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësi, duke vepruar në mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon, se kupton tregime, përshkrime, biseda, diskutime, informacion dhe lajme rreth temave të njohura, duke e bërë një përmbledhje të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme dhe disa nuanca.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton udhëzime gojore të qarta dhe me hollësi, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p>

Njohuria e kërkuar

Të kuptuarit përmes leximit

Kursi A

Nxënësi mund të nxjerr, lexojë dhe të kuptojë informacion të thjeshtë, në situata konkrete të përditshmërisë.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi mund të nxjerr dhe të kuptoj informacion në formë të fjalëve të zakonshme dhe simboleve, si dhe shumë fraza të thjeshta.</p> <p>Nxënësi lexon dhe kupton tekste shumë të thjeshta e të përshtatur për ndonjë temë të mirënjohur.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi mund të nxjerr dhe të kuptoj informacion në formë të fjalëve të zakonshme dhe simboleve, si dhe fraza të thjeshta.</p> <p>Nxënësi lexon dhe kupton tekste të thjeshta të përshtatura për ndonjë temë të mirënjohur.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi mund të nxjerr dhe të kuptoj informacion në formë të fjalëve të zakonshme dhe simboleve, si dhe fraza dhe fjali të thjeshta.</p> <p>Nxënësi lexon dhe kupton tekste të shkurta e të thjeshta, për ndonjë temë të mirënjohur.</p>

Kursi B

Nxënësi mund të lexojë, kuptojë dhe të përdorë tekste të thjeshta në situata të njohura e të përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi lexon tekste të përshtatura dhe përshkruese, rreth temave të mirënjohura dhe këtë e tregon duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe personale, informacion konkret, të shkurtë, udhëzime të qarta dhe të thjeshta, duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedh dhe përdorë disa strategji leximi, kryesisht në një mënyrë funksionale.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste të përshtatura, rrëfyese dhe përshkruese, rreth temave të mirënjohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe personale, informacion konkret, të shkurtë, udhëzime të qarta dhe të thjeshta, duke vepruar në mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedh dhe përdorë disa strategji leximi, në mënyrë të përshtatshme.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese, të përshtatura dhe përshkruese, rreth temave të mirënjohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme me ndonjë nuancë.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton mesazhe personale, informacion konkret, udhëzime të shkurta e të qarta dhe të thjeshta, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedh dhe përdorë disa strategji leximi, në një mënyrë efikase e të përshtatshme.</p>

Kursi C

Nxënësi mund të lexojë, kuptojë dhe të përdorë tekste të rëndomta të jetës së përditshme shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi lexon tekste të shkurta, rrëfyese dhe përshkruese, rreth temave të njohura dhe këtë e tregon se kupton, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste me fakte, tabela dhe diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të thjeshta rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime, udhëzime dhe urdhëra të qarta dhe të shkurta, duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategjitë e leximit, kryesisht në një mënyrë funksionale, sipas qëllimit të leximit.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese dhe përshkruese, rreth temave të njohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste me fakte, tabela, diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të thelluara rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime, udhëzime dhe urdhëra të qarta dhe të shkurta, duke vepruar në mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategjitë e ndryshme leximi, në mënyrë adekuate, sipas qëllimit të leximit.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese të shkurta dhe përshkruese, rreth temave të njohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të thjeshta të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme, me disa nuanca.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste të thjeshta me fakte, tabela, diagrame dhe mund të bëjë shpjegime të thelluara mirë rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime, udhëzime dhe urdhëra të qarta dhe të shkurta, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategjitë e ndryshme leximi, në mënyrë efikase dhe adekuate, sipas qëllimit të leximit.</p>

Kursi D

Nxënësi mund të lexojë, kuptojë dhe të përdorë tekste të thjeshta, deri diku të ndërlikuara, në jetën e përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të përmbajtjes kryesore.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste me fakte dhe mund të bëjë shpjegime të thjeshta rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta, duke vepruar kryesisht në një mënyrë funksionale sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategjitë e ndryshme leximi, kryesisht në një mënyrë funksionale, bazuar në qëllimin e leximit.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste me fakte, dhe mund të bëjë shpjegime të thelluara rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta, duke vepruar në mënyrë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategjitë e ndryshme leximi në mënyrë adekuate, sipas qëllimit të leximit.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi lexon tekste rrëfyese, përshkruese dhe argumentuese rreth temave të njohura dhe këtë e tregon, duke bërë përmbledhje të përmbajtjes kryesore dhe duke komentuar hollësisht të rëndësishme, me disa nuanca.</p> <p>Nxënësi nxjerr informacion specifik në tekste me fakte, dhe mund të bëjë shpjegime të thelluara mirë rreth informacionit.</p> <p>Nxënësi tregon, se kupton përshkrime dhe udhëzime të qarta, duke vepruar në mënyrë të mirë funksionale, sipas atyre udhëzimeve.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë strategji të ndryshme leximi në mënyrë efikase dhe adekuate, sipas qëllimit të leximit.</p>

Njohuria e kërkuar

Bashkëveprimi gojor

Kursi A

Nxënësi mund të lidhë kontakte sociale dhe me mbështetje, komunikon në situatat konkrete të përditshmërisë.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të Përditshme, duke përdorur fjalë dhe fraza të thjeshta përshëndetëse, lamtumirëse dhe mirësjellëse, bën pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e thjeshta, varësisht nga nevoja konkrete.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë kryesisht në një mënyrë funksionale gjeste, pyetje dhe strategjitë e tjera, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të përditshme, duke përdorur fjalë dhe fraza të zakonshme, bën pyetje dhe përgjigjet në pyetje të thjeshta, varësisht nga nevoja konkrete.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate, gjeste, pyetje dhe strategjitë e tjera, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda shumë të thjeshta e të përditshme, duke përdorur fjalë, fraza dhe fjali, bën pyetje dhe përgjigjet në pyetje të thjeshta, varësisht nga nevoja konkrete.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate dhe në mënyrë efikase, gjeste, pyetje dhe strategjitë e tjera, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>

Kursi B

Nxënësi me mbështetje mund të komunikojë, në situata të zakonshme në jetën e përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të mirënjohura, duke paraqitur dhe reaguuar ndaj pohimeve, pikëpamjeve dhe dëshirave, si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në një mënyrë që pjesërisht të mbahet rrjedha e bisedës.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë kryesisht në një mënyrë funksionale strategjitë, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të mirënjohura, duke paraqitur dhe reaguuar ndaj pohimeve, pikëpamjeve dhe dëshirave, si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në një mënyrë që të mbahet rrjedha e bisedës relativisht mirë.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate strategjitë, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda të thjeshta rreth temave të mirënjohura, duke paraqitur dhe reaguuar ndaj pohimeve, pikëpamjeve dhe dëshirave si dhe bën pyetje dhe përgjigjet në një mënyrë që të mbahet rrjedha e bisedës mirë.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate dhe efikase strategjitë, për të kuptuar dhe për t'a kuptuar.</p>

Kursi C

Nxënësi mundet, me një përshtatje të vogël të synimit dhe partnerit të bisedës, të komunikojë me një gjuhë të thjeshtë, në situata të zakonshme, në jetën e përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta, rreth temave të njohura, duke paraqitur dhe pyetur rreth pikëpamjeve, mendimeve dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon pjesërisht përpara.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, strategjitë, të cilat e lehtësojnë bashkëveprimin.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta, rreth temave të njohura, duke paraqitur dhe pyetur rreth pikëpamjeve, mendimeve dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë Adekuate, strategjitë të cilat lehtësojnë bashkëveprimin.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime të thjeshta, rreth temave të njohura, duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, pikëpamjeve dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara dhe i thëllon apo i zgjeron ato.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë të cilat lehtësojnë bashkëveprimin.</p>

Kursi D

Nxënësi mundet, me një përshtatje të vogël të synimit dhe partnerit të bisedës, të komunikojë, si në situata joformale edhe në ato më shumë formale, në jetën e përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime, rreth temave të njohura, duke u shprehur dhe përgjigjur pikëpamjeve me argumente të thjeshta, si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon pjesërisht përpara.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, strategjitë të cilat zgjedhin problemet e bashkëveprimit.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime, rreth temave të njohura, duke u shprehur dhe përgjigjur pikëpamjeve me argumente të thelluara, si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve, dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë adekuate, strategjitë të cilat zgjedhin problemet e bashkëveprimit.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi merr pjesë në biseda dhe diskutime, rreth temave të njohura, duke u shprehur dhe përgjigjur pikëpamjeve me argumente të thelluara mirë, si dhe duke paraqitur dhe pyetur rreth mendimeve dhe informatave, në një mënyrë që bisedat dhe diskutimet i çon përpara dhe i thëllon apo i zgjeron ato.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë të cilat zgjedhin problemet e bashkëveprimit.</p>

Njohuria e kërkuar

Prodhim gojor

Kursi A

Nxënësi mundet me mbështetje të komunikojë, me një gjuhë të thjeshtë, në disa situata, që ka të bëjë me vetveten.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
Nxënësi tregon me fjalë të zakonshme dhe me fraza të thjeshta, për rrethanat dhe përvojat personale. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, gjestet dhe strategjitë e tjera, për t'a kuptuar të tjerët.	Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.	Nxënësi tregon me fjalë dhe fraza të zakonshme, për rrethanat dhe përvojat personale. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në një mënyrë adekuate, gjestet dhe strategjitë e tjera, për t'a kuptuar të tjerët.	Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.	Nxënësi tregon me fjali dhe fraza koherente, për rrethanat dhe përvojat personale. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë efikase dhe adekuate, gjestet dhe strategjitë e tjera, për t'a kuptuar të tjerët.

Kursi B

Nxënësi mundet me mbështetje të komunikojë, me një gjuhë të thjeshtë dhe me ndihmën e gjesteve, në situata të zakonshme të jetës së përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
Nxënësi tregon në formë të thjeshtë, rreth përvojave personale dhe personave të mirënjohur, vendeve dhe ngjarjeve. Nxënësi shprehet kuptueshëm dhe pjesërisht koherent. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, disa strategji për t'a kuptuar të tjerët.	Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.	Nxënësi tregon në formë të thelluar rreth përvojave personale dhe personave të mirënjohur, vendeve dhe ngjarjeve. Nxënësi shprehet relativisht qartë dhe koherent. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në një mënyrë adekuate, disa strategji, për t'a kuptuar të tjerët.	Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.	Nxënësi tregon në formë të thelluar rreth përvojave personale dhe personave të mirënjohur, vendeve dhe ngjarjeve. Nxënësi shprehet qartë, mirë e koherent. Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në një mënyrë efikase dhe adekuate, disastrategji, për t'a kuptuar të tjerët.

Kursi C

Nxënësi mundet, me një përshtatje të vogël të synimit dhe bashkëbiseduesit, të komunikojë me një gjuhë të thjeshtë, në situata të zakonshme të jetës së përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të thjeshtë rreth përvojave dhe pikëpamjeve personale, rreth temave të njohura, si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.</p> <p>Nxënësi shprehet kuptueshëm dhe pjesërisht koherent, si dhe jep prova të një variacioni të caktuar gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, strategjitë e ndryshme, për të përmirësuar komunikimin.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të thelluar rreth përvojave dhe pikëpamjeve personale, për temat e njohura, si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.</p> <p>Nxënësi shprehet relativisht qartë dhe koherent, si dhe jep prova për një variacion relativisht të mirë gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate, strategjitë e ndryshme, për të përmirësuar komunikimin.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë më të thelluar, rreth përvojave personale dhe pikëpamjeve, për temat e njohura, si dhe jep këshilla dhe udhëzime të thjeshta.</p> <p>Nxënësi shprehet qartë, mirë dhe koherent, si dhe jep prova për një variacion të mirë gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë e ndryshme, për të përmirësuar komunikimin.</p>

Kursi D

Nxënësi mundet, me një përshtatje të vogël të synimit dhe bashkëbiseduesit, të komunikojë, si në situata joformale edhe në ato më shumë formale, në jetën e përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të thjeshtë ngjarjet aktuale, përvojat, përshtypjet dhe pikëpamjet, si dhe jep këshilla dhe udhëzime.</p> <p>Nxënësi shprehet deri diku rrjedhshëm dhe pjesërisht koherent, si dhe tregon një variacion të caktuar gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në një mënyrë funksionale, strategjitë e ndryshme, për të përmirësuar komunikimin.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të thelluar ngjarjet aktuale, përvojat, përshtypjet dhe pikëpamjet, si dhe jep këshilla dhe udhëzime.</p> <p>Nxënësi shprehet relativisht me rrjedhshmëri të mirë, koherente dhe tregon një variacion relativisht të mirë gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë adekuate, strategjitë e ndryshme, për të përmirësuar komunikimin.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi tregon dhe përshkruan në formë të thelluar dhe mirë, ngjarjet aktuale, përvojat, përshtypjet dhe pikëpamjet, si dhe jep këshilla dhe udhëzime.</p> <p>Nxënësi shprehet me rrjedhshmëri të mirë dhe shumë koherent, si dhe tregon një variacion të mirë gjuhësor.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë për të përmirësuar komunikimin.</p>

Njohuria e kërkuar

Aftësi shkrimi

Kursi A

Nxënësi mund të administrojë shkrimin, në disa situata të përditshmërisë.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi shkruan me fjalë të thjeshta dhe simbole, të dhënat personale, në disa situata të zakonshme.</p> <p>Nxënësi shkruan kryesisht në mënyrë funksionale, nga një informacion i rëndësishëm, sipas nevojave personale.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan me fjalë, simbole dhe me fraza të thjeshta, të dhënat personale, në disa situata të zakonshme.</p> <p>Nxënësi shkruan në mënyrë funksionale, nga një informacion i rëndësishëm, sipas nevojave personale.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan me fjalë, simbole dhe me fraza, të dhënat personale, në disa raste të zakonshme.</p> <p>Nxënësi shkruan në mënyrë të mirë funksionale, nga një informacion i rëndësishëm, sipas nevojave personale.</p>

Kursi B

Nxënësi mund të shkruaj disa tekste të thjeshta, për të komunikuar në situata të rëndomta, në jetën e përditshme.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi shkruan mesazhe të thjeshta dhe të shkurta kuptueshëm, përshëndetje dhe tekste rreth vetvetes dhe rreth ngjarjeve të përjetuara.</p> <p>Nxënësi krijon kryesisht në mënyrë funksionale dhe koherente.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në mënyrë funksionale, disa strategji në të shkruar.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan mesazhe të thjeshta, të shkurta dhe relativisht të qarta, përshëndetje, tekste rreth vetvetes dhe rreth ngjarjeve të përjetuara.</p> <p>Nxënësi krijon në mënyrë funksionale dhe koherente.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në një mënyrë adekuate, disa strategji në të shkruar.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan mesazhe të thjeshta, të shkurta dhe të qarta, përshëndetje dhe tekste rreth vetvetes dhe rreth ngjarjeve të përjetuara.</p> <p>Nxënësi krijon në mënyrë të mirë, funksionale dhe koherente.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë efikase dhe adekuate, disa strategji në të shkruar.</p>

Kursi C

Nxënësi mund të shkruaj tekste të thjeshta, me një përshtatje të vogël të synimit dhe bashkëbiseduesit, për të komunikuar në situata të zakonshme, të jetës së përditshme, shoqërore, studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi shkruan tekste në mënyrë koherente dhe të kuptueshme, rreth përvojave, përshtypjeve, pikëpamjeve si dhe teksteve me fakte, rreth temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon kryesisht një strukturë në mënyrë funksionale, në tekstet e veta dhe tregon prova të një variacioni të caktuar të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë kryesisht në mënyrë funksionale, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan tekste në mënyrë koherente dhe relativisht të qarta, rreth përvojave, përshtypjeve, pikëpamjeve si dhe teksteve me fakte, rreth temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon një strukturë të mirë e funksionale në tekstet e veta dhe tregon provë për variacion relativisht të mirë, të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë adekuate, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan tekste në mënyrë koherente dhe të qarta rreth përvojave, përshtypjeve, pikëpamjeve, si dhe teksteve me fakte rreth temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon një strukturë të mirë funksionale në tekstet e veta dhe tregon provë për variacion të mirë, të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi zgjedh dhe përdorë në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>

Kursi D

Nxënësi mund të shkruaj tekste të thjeshta, me një përshtatje të vogël të synimit dhe bashkëbiseduesit, për të komunikuar si në situata joformale dhe ato më shumë formale, në jetën e përditshme, shoqërore studimore dhe të punës.

Nota E	Nota D	Nota C	Nota B	Nota A
<p>Nxënësi shkruan deri diku rrjedhshëm, tekste përshkruese, raportuese dhe argumentuese, të temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon kryesisht një strukturë funksionale tekstet e veta dhe tregon variacion të caktuar të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi përdorë me një siguri të caktuar struktura të thjeshta dhe të avancuara gramatikore, në tekstet e veta.</p> <p>Nxënësi mban dhe përmbledhë, kryesisht në mënyrë funksionale, shënimet për atë që shkruan vet.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë, kryesisht në mënyrë funksionale, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>	<p>Nota D do të thotë, se kërkesat e njohurive për E dhe për pjesën më të madhe të C-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan me një rrjedhshmëri relativisht të mirë, tekste përshkruese, raportuese dhe argumentuese, të temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon një strukturë funksionale në tekstet e veta dhe tregon një variacion relativisht të mirë, të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi përdorë, me një siguri relativisht të mirë, si struktura të thjeshta dhe struktura të avancuara gramatikore, në tekstet e veta.</p> <p>Nxënësi mban dhe përmbledhë në një mënyrë funksionale shënimet për atë që shkruan vet.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në një mënyrë adekuate, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>	<p>Nota B do të thotë, se kërkesat e njohurive për C dhe për pjesën më të madhe të A-së, janë përmbushur.</p>	<p>Nxënësi shkruan me një rrjedhshmëri të mirë, tekste përshkruese, raportuese dhe argumentuese të temave të njohura.</p> <p>Nxënësi krijon një strukturë të mirë funksionale në tekstet e veta dhe tregon një variacion të mirë të fondit të fjalëve dhe ndërtimit të fjalive.</p> <p>Nxënësi përdorë me një siguri të mirë, si struktura të thjeshta ashtu edhe struktura të avancuara gramatikore, në tekstet e veta.</p> <p>Nxënësi mban dhe përmbledhë në një mënyrë të mirë funksionale shënimet për atë që shkruan vet.</p> <p>Nxënësi zgjedhë dhe përdorë në mënyrë efikase dhe adekuate, strategjitë e ndryshme në të shkruar.</p>

Skolverket

Swedish National Agency for Education
www.skolverket.se